

Shoqatat e UÇK-së
bëjnë thirrje për
pjesëmarrje masive në
marshin e 12 shtatorit

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PROKURORIA SPECIALE E KOSOVËS NGRE AKTAKUZË NDAJ 35 TË PANDEHURVE PËR KRIME LUFTË NË LAGJEN E JASHARËVE NË PREKAZ

FAQE 4-5



Prekaz, Skenderaj. Shtëpitë e Familjës Jashari, shek. XX, pas sulmit të forcave serbe, mars 1998.
The houses of the Jashari family in the village of Prekaz, Skenderaj, XX century, after the Serbian attack in March 1998.
Die Häuser der Familie Jashari in Prekaz, Skenderaj im 20. Jahrhundert nach dem Angriff der serbischen Kräfte im März 1998.

Radio Evropa e Lind (RFE/RL)

Prokuroria Speciale e Kosovës ka dorëzuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë aktakuzë në mungesë ndaj 35 të pandehurve për krime lufte në lagjen e Jasharëve në Prekaz më 1998. Të

pandehurit, që sipas Prokurorisë Speciale, u përkasin pozitive të larta komanduese të strukturave të njësive speciale të policisë serbe dhe të njëjtit akuzohen për vrasjen e civilëve. "Provat e

siguruara kanë vërtetuar se në këtë sulm janë vrarë 26 persona civilë, në mesin e të cilëve fëmijë, gra dhe të moshuar", tha prokurori Valdet Gashi gjatë një konference për media

**A MUND TË FAJËSOHEN
GJASHTË
DEPUTETË PËR
DËSHTIMIN E
ZGJEDHJES SË
PRESIDENTIT?** F. 4



**DEHARI ÇAKTON
9 SHTATORIN
PËR VAZHDIMIN
E SEANCËS
KONSTITUIVE
TË KUVENDIT
TË KOSOVËS** F. 5



**FERMERËT SHOHIN KTHESË NË
TREGUN E QUMËSHITIT** F. 8

SPORT



**KOSOVA MERR FLAMURIN
E LOJËRAVE MESDHEWARE,
"PRISHTINA 2030" ZYRTARISHT
NË SKENËN MESDHEWARE** F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

Endrit Shaqiri
+38344685122

INFINITY
Digital Agency
Internet Website,
Marketing...

NË TAKIMIN ME MINISTRAT E BE-së, KOSOVA KËRKON SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR ANËTARËSIM

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Në takimin joformal mes ministrave për çështje evropiane të Bashkimit Evropian dhe atyre të vendeve të Ballkanit Perëndimor, kërkesa kryesore e Kosovës është që aplikimi për anëtarësim në bllok të lëvizë përpara. “Ne duam që aplikimi i Kosovës të lëvizë përpara dhe të hapen bisedimet për anëtarësim. Jemi shteti i vetëm që nuk ka statusin e vendit kandidat. BE-ja duhet të japë rezultate në këtë drejtim. Jam këtu për ta shtyrë përpara këtë mesazh”, tha për gazetarët Jeton Zulfaj, kryenegociator i Kosovës me BE-në.

I pyetur se çfarë mesazhi jep BE-ja për qytetarët e Kosovës pasi as pas katër vjetësh aplikimi i Kosovës nuk është trajtuar nga blloku, Zulfaj tha se nuk po përçohet një mesazh i mirë. “Nuk është mesazh i mirë dhe tregon mungesë të leadershipit në BE dhe mendoj që kjo është përgjegjësi e përbashkët. BE-ja duhet ta bëjë pjesën e saj dhe arritja e konsensusit brenda bllokut duhet të jetë përgjegjësi e BE-së. Çdo vend, i madh apo i vogël, duhet ta ndiejë urgjencën për unitet brenda BE-së”, u shpreh ai.

Kosova ka dorëzuar aplikimin për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit 2022. Megjithatë, ky

aplikim ende nuk ka kaluar as në fazën e parë formale, atë të shqyrtimit nga Këshilli i BE-së dhe më pas dërgimit për opinion në Komisionin Evropian. Kosova është vendi i vetëm në rajon që nuk ka statusin e vendit kandidat.

Takimi në Irlandë mes ministrave të shteteve anëtare të ngarkuar për çështjet evropiane dhe homologëve nga Ballkani Perëndimor përqendrohet në procesin e zgjerimit të bllokut.

Ky është një takim joformal që mbahet në prag të propozimeve të reja në procesin e anëtarësimit për shtetet kandidate.

Komisioni Evropian pritet që më 30 shtator të publikojë të ashtuquajturin rishikim para anëtarësimit, i cili do t'i përfshijë edhe mekanizmat mbrojtës në traktatat e anëtarësimit ndërmjet BE-së dhe anëtarëve të ardhshëm. Bashkimi Evropian po punon për të siguruar që shtetet anëtare, pas anëtarësimit të plotë, të mos shënojnë prapaktim në demokraci dhe sundimin e ligjit, siç ka ndodhur me Hungarinë, Sllovakinë ose Poloninë. “Bazuar në përvojën e së kaluarës, veçanërisht që nga zgjerimi i vitit 2004, e dimë se nuk mund të jemi gjithmonë të sigurt se, kur të kemi anëtarë të rinj, përkatësisht shtete të reja anëtare të BE-së, ata do ta



respektojnë sundimin e ligjit dhe, veçanërisht, gjithçka që ndodh brenda BE-së”, deklaroi komisionarja evropiane për Zgjerim, Marta Kos. “Po ashtu, po flas për bashkëpunimin e sinqertë, të përcaktuar në nenin 4 të Traktatit. Pra, bëhet fjalë për mënyrën se si mund të jemi të sigurt se të gjitha shtetet anëtare do t'u përmbahen vlerave tona dhe do të zbatojnë vërtet atë që është rënë dakord në nivelin e të gjitha shteteve anëtare. Në të kaluarën ka ndodhur që diçka të jetë rënë dakord, si për shembull dhënia e statusit të kandidatit Ukrainës, por më pas Hungaria të bllokojë përparimin e mëtejshëm”, shtoi ajo.

Takimi zhvillohet edhe në dritën e propozimit më të fundit të 11 shteteve anëtare të BE-së, të cilat kërkojnë ndryshimin e

mënyrës së vendimmarrjes në fushën e politikës së jashtme dhe zëvendësimin e konsensusit me votimin me shumicë të cilësuar. “Qëndrimi i Komisionit Evropian është se, veçanërisht në fushat që janë të rëndësishme për funksionimin tonë, si politika e jashtme dhe e sigurisë, duhet të kalojmë nga vendimmarrja unanime në votimin me shumicë të cilësuar. Por, ka edhe shumë reforma të tjera që mund t'i ndërmarrim”, tha Kos.

Testi i parë i mekanizmave të paralajmëruar mbrojtës do të jetë në rastin e Malit të Zi, shtetit më të avancuar në procesin e integritimit në BE. Tashmë ka nisur hartimi i projektit të tekstit të Traktatit të Anëtarësimit.

Këtë e la të kuptohej edhe Benjamin Haddad, ministri

francez përgjegjës për çështjet evropiane. “Sa iu përket klauzolave mbrojtëse, do të punojmë për to në kuadër të Traktatit të Anëtarësimit me Malin e Zi, së bashku me grupin ad-hoc që është formuar për këtë qëllim. Siç e dini, kjo është bërë edhe më herët, për shembull me Kroacinë, kur u vendosën një numër i caktuar klauzolah mbrojtëse dhe fazash kalimtare, për të siguruar masa dhe mekanizma mbrojtës që ky anëtarësim të ishte i suksesshëm”, deklaroi Haddad në Irlandë. “Synimi ynë, natyrisht, është të jemi në gjendje të përparojmë si 27 shtete, së bashku me partnerët tanë nga Mali i Zi, të cilët po përparojnë në rrugën e reformave dhe integritimit në acquis të Bashkimit”, shtoi ai.

Sipas tij, është e rëndësishme që klauzolat mbrojtëse të jenë të përkohshme. Për komisionaren evropiane Kos këta mekanizma nuk do të nënkuptojnë se anëtarët e ardhshëm do të trajtohen si “anëtarë të dorës së dytë”. Mekanizmat mbrojtës më pas do të përfshihen edhe në tekstet e anëtarëve të tjerë potencialë. Në tetor liderët e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian do t'ia kushtojnë diskutimin procesit të zgjerimit si dhe reformave në këtë proces.

MINISTRI IRLANDEZ: VARRIMI SHTETËROR PËR MLLADIQIN OSE PJESËMARRJA E PUSHTETIT NË TË, TË PAPRANUESHME PËR BE-NË

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Varrimi shtetëror për të dënuarin për krime lufte, Ratko Mlladiq ose pjesëmarrja e anëtarëve të Qeverisë së Serbisë në varrimin e tij, janë të papranueshme për Bashkimin Evropian, ka paralajmëruar Thomas Byrne, ministri irlandez për Çështjet Evropiane, vendi i të cilit aktualisht mban presidencën e bllokut evropian. Ai konfirmoi se zyrtarët evropianë “po punojnë shumë në prapaskenë” lidhur me këtë çështje. “Besoje se një varrim shtetëror do të ishte i papranueshëm. Sa kuptoj unë, në fakt nuk po organizohet një varrim shtetëror, por është krejt e mundshme që zyrtarë të lartë të pushtetit t'i bëjnë nderime atij personi. Pra, edhe kjo është e papranueshme”, deklaroi Byrne para takimit joformal të ministrave të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor që po

mbahet në Irlandë.

Ai i cilësoi zhvillimet gjatë viteve '90 në rajonin e Ballkanit Perëndimor si “të neveritshme”. “Por, mos kini asnjë dyshim, ajo që po ndodh atje, sipas mendimit tim, ende u shkakton dhimbje njerëzve, veçanërisht në atë rajon, por edhe në disa shtete anëtare të Bashkimit Evropian”, vlerësoi Byrne.

Aeroplani me trupin e pagjetë Ratko Mlladiqit, i cili vdiq më 27 gusht në Hagë, arriti të enjten, më 3 shtator, në aeroportin “Nikola Tesla” të Beogradit. Në aeroplan, përveç anëtarëve të familjes, ndodheshin edhe ministri i Drejtësisë i Serbisë, Nenad Vujiq, dhe dy bashkëluftëtarë të Mlladiqit.

Arkivoli me trupin e Mlladiqit ishte i mbuluar me flamurin e Serbisë dhe u mbajt nga pjesëtarë të Ushtrisë së Serbisë. Djali i tij deklaroi se Mlladiqi do



të varroset të hënën, më 7 shtator, në varrezat e Topçiderit.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, kishte thënë më herët se pret që djali i Mlladiqit “në ditët në vijim t'i njoftojë të gjithë për atë që dëshiron familja”. Megjithatë, ai ka shtuar se shteti do të jetë i gatshëm të

ofrojë çdo lloj mbështetjeje logjistike, transporti dhe të tjera, si dhe të ndihmojë në ruajtjen e rendit publik, paqes dhe sigurisë.

Më herët, ministri Vujiq kishte thënë se Mlladiqi do të varroset me nderimet më të larta shtetërore.

Komisioni Evropian, ndërkaq,

ka thënë se u takon autoriteteve të Serbisë të vendosin se çfarë roli do të kenë në varrimin e Mlladiqit, por ka theksuar se madhërimi i kriminelëve të luftës është në kundërshtim me vlerat më themelore evropiane dhe se për të nuk ka vend as në Bashkimin Evropian, as në vendet kandidate për anëtarësim.

Ministri irlandez për Çështjet Evropiane bëri thirrje se është koha për ta lënë të kaluarën pas dhe për të punuar në pajtimin si dhe që procesi i pajtimit në Ballkanin Perëndimor të vazhdojë.

Tribunali i Hagës e dënoi Ratko Mlladiqin me burgim të përjetshëm më 8 qershor 2021. Gjykata konstatoi se ai ishte fajtor për gjenocidin e kryer ndaj rreth 8 000 boshnjakëve në Srebrenicë, zonë e mbrojtur nga Kombet e Bashkuara, në verën e vitit 1995.

PROKURORIA SPECIALE E KOSOVËS NGRE AKTAKUZË NDAJ 35 TË PANDEHURVE PËR KRIME LUFTE NË LAGJEN E JASHARËVE NË PREKAZ

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Prokuroria Speciale e Kosovës ka dorëzuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë aktakuzë në mungesë ndaj 35 të pandehurve për krime lufte në lagjen e Jasharëve në Prekaz më 1998.

Të pandehurit, që sipas Prokurorisë Speciale, u përkasin pozitive të larta komanduese të strukturave të njësive speciale të policisë serbe dhe akuzohen për vrasjen e civilëve. “Provat e siguruar kanë vërtetuar se në këtë sulm janë vrarë 26 persona civilë në mesin e të cilëve fëmijë, gra dhe të moshuar”, tha prokurori Valdet Gashi.

Ndërkaq kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj, tha se është konstatuar ngjarjet në Prekaz në mars të vitit 1998 ndodhën “me paramendim” dhe “me përgatitje paraprake”.

Prokurori Gashi tha se viktimat civile ishin banorë të lagjes së

Jasharëve, duke sqaruar se nuk bëhet fjalë vetëm për viktimat nga familja e ngushtë e Shaban Jasharit. Ai, po ashtu, sqaroi se numri i viktimave civile është 26, pasi në të nuk janë përfshirë personat që kanë qenë pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Sipas Gashit, prokuroria, bazuar në provat e siguruar për ngjarjet më 5, 6 dhe 7 mars 1998, ka arritur të vërtetojë se “cilat njësi të forcave serbe kanë marrë pjesë në sulm, pozicioni prej ku kanë sulmuar, aktivitetet e secilit prej të pandehurve, arsenalin e armëve që janë përdorur dhe dëmet e shkaktuara si në njerëz dhe materiale”.

I pyetur se për cilat njësi kanë marrë pjesë në sulmin në lagjen e Jasharëve në Prekaz, prokurori Gashi përmendi disa prej tyre, por shtoi se janë shumë më shumë. “Departamenti i Sigurisë Publike ka qenë i inkuadruar, mandej Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti i Sigurisë Shtetërore dhe në



kuadër të Departamentit të Sigurisë Shtetërore ka qenë edhe Njësia për Operacione Speciale e Serbisë. Këtë njësi e ka udhëhequr Millorad Ulemek Legija, i cili e ka pasur për obligim dhe për detyrë, dhe me kërkesën e tij speciale, që ta sulmojë drejtpërdrejtë shtëpinë e Shaban Jasharit”, tha Prokurori Gashi.

Kryeprokurori i Speciales, Blerim Isufaj, tha se aktakuza është punuar me kujdes dhe bazohet në prova, duke

theksuar se tani është në kompetencën gjykatës që ta vlerësojë atë. Ai e vlerësoi si aktakuzë me rëndësi të veçantë dhe tha se është dëshmi e përkushtimit të institucionit që ai udhëheq për trajtimin e krimeve të luftës dhe kërkimit të përgjegjësisë penale pavarësisht kompleksitetit të rastit dhe kohës së kaluar nga kryerja e krimeve.

Sipas informacioneve të Prokurorisë Speciale, të gjithë të pandehurit për vrasjen e

civilëve në Prekaz janë të gjallë. Prokurorët gjatë konferencës për medie u pyetën nëse kanë njohuri nëse ndonjëri prej të pandehurve është pjesë e institucioneve të Serbisë. “Nuk e kemi këtë informacion, por referuar moshës besoj se shumica nga ta janë të pensionuar”, tha Prokurori Gashi.

Më 5, 6 dhe 7 mars, forcat serbe vranë më shumë se 50 persona gjatë sulmit në Prekaz ndaj familjes së heroit të Kosovës, Adem Jashari, një prej themeluesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Prokuroria Speciale e Kosovës vitet e fundit ka ngritur një sërë aktakuzash për krime lufte kundër popullatës civile më 1998/99. Disa raste janë në gjykim dhe disa kanë marrë edhe epilog gjyqësor. Më herët ky institucion ka ngritur aktakuzë në mungesë kundër 21 të dyshuarve për dëbimin me forcë të mbi 800 000 civilëve shqiptarë nga Kosova gjatë luftës.

SHOQATAT E UÇK-së BËJNË THIRRJE PËR PJESËMARRJE MASIVE NË MARSHIN E 12 SHTATORIT

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së dhe Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së kanë mbajtur konferencë për medie, ku kanë bërë thirrje për pjesëmarrje masive në marshin e 12 shtatorit dhe për organizimin e pritjes së verdiktit përfundimtar ndaj krerëve të UÇK-së në Hagë. Kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Xhavit Jashari, tha se Gjykata Speciale është krijuar mbi baza politike dhe e cilësoi procesin ndaj ish-krerëve të UÇK-së si të padrejtë. “Kjo konferencë është njoftim për



organizimin e pritjes së verdiktit përfundimtar të krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të

cilët gati gjashtë vjet po mbahen padrejtesisht atje”, deklaroi Jashari.

Ai tha se organizatat po bashkëpunojnë për pritjen e vendimit më 16 shtator, duke theksuar se, pavarësisht se nuk janë organizatorë të protestës së 12 shtatorit, e mbështesin atë dhe u bëjnë thirrje qytetarëve që të marrin pjesë.

Jashari tha se lufta e UÇK-së dhe krerët e saj janë të lidhur me lirinë dhe shtetësinë e Kosovës, ndërsa u bëri thirrje institucioneve, partive politike dhe shqiptarëve kudo që janë që të marrin pjesë në marsh.

Ndërkaq, kryetari i Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së,

Fadil Shurdhaj, ftoi veteranët, invalidët, familjet e dëshmorëve dhe të gjithë qytetarët që më 12 shtator, në orën 14:00, t'i bashkohen protestës në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë. Shurdhaj u bëri thirrje edhe shqiptarëve nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva e Medvegja dhe mërgimtarëve që t'i bashkohen protestës. “U bëj thirrje veteranëve, invalidëve, familjeve të dëshmorëve dhe gjithë njerëzve që e duan lirinë dhe Kosovën të jenë me ne në sheshin ‘Skënderbeu’ më 12 shtator”, tha Shurdhaj.

ANËTARËT E KËSHILLIT GJYQËSOR DHE KRYETARËT E GJYKATAVE DISKUTOJNË PËR PËRMIRËSIMIN E FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT GJYQËSOR

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK), me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), po zhvillon një punëtori treditore me drejtuesit e institucioneve gjyqësore, me fokus në avancimin e funksionimit dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor.

Gjatë punëtorisë po diskutohen çështje me rëndësi për punën e KGjK-së dhe gjykatave, përfshirë zbatimin e Planit të Punës së KGjK-së

për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026, procesin e vlerësimit të performancës së gjyqtarëve, planet e punës së komisioneve të Këshillit dhe çështjet buxhetore.

Një pjesë e rëndësishme e diskutimeve i kushtohet Planit të Rritjes Ekonomike për Ballkanin Perëndimor, me fokus në obligimet e KGjK-së dhe gjykatave për zbatimin e reformave, si dhe në mekanizmat e raportimit dhe monitorimit të progresit. Po ashtu, po trajtohet përdorimi i



raporteve statistikore të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), si një nga mekanizmat për monitorimin e punës dhe

rritjen e efikasitetit në menaxhimin e lëndëve. Punëtorja synon ta forcojë koordinimin ndërmjet KGjK-së dhe gjykatave, t'i

identifikojë sfidat dhe masat konkrete për përmirësimin e punës së sistemit gjyqësor, si dhe të kontribuojë në përmbushjen e objektivave strategjike të përcaktuara nga Këshilli.

Në punëtori po marrin pjesë kryetari i Gjykatës Supreme, kryesuesi i KGjK-së, anëtarët e Këshillit, kryetari i Gjykatës së Apelit, kryetari i Gjykatës Komerciale, kryetarët e Gjykatave Themelore dhe drejtorët e Sekretariatit të KGjK-së.



A MUND TË FAJËSOHEN GJASHTË DEPUTETË PËR DËSHTIMIN E ZGJEDHJES SË PRESIDENTIT?

Debati për zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës është zhvendosur te gjashtë deputetë të LDK-së që nuk pranojnë ta mbështesin kandidatin për të cilin partia e tyre u mor vesh me LV-në. Qëndrimi i tyre ka shkaktuar përplasje me udhëheqjen e partisë dhe ka rrezikuar marrëveshjen politike për zgjedhjen e presidentit. Por, a mund të mbahen përgjegjës vetëm këta deputetë?

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Një marrëveshje politike për zgjedhjen e presidentit të ardhshëm të Kosovës ngjalli shpresa se vendi më në fund do të mund të dilte nga kriza gati dyvjeçare politike. Por, ato shpresa u shuan shpejt, kur edhe deputetë nga njëra palë e marrëveshjes i dolën ujdise kundër. Përgjegjësia për dështimin e zgjedhjes së presidentit, e cila deri tani ishte bartur herë te njëra e herë te pala tjetër, tash po u vihet gjashtë deputetëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) – nga vetë kryetari i partisë, Lumir Abdixhiku, si dhe nga homologu i tij nga Lëvizja Vetëvendosje, Albin Kurti. Kandidati i tyre, Bekim Sejdiu, nuk duket ta ketë mbështetjen e nevojshme për t'u zgjedhur president i ri i Kosovës.

Vota individuale përballë qëndrimit partiak

Njohës të çështjeve juridike e politike thonë për Radion Evropë e Lirë (REL) se përgjegjësia për zgjedhjen e

presidentit në një Kuvend prej 120 deputetësh nuk mund të kufizohet në gjashtë deputetë të caktuar. Sipas tyre, marrëveshjet politike mes partive nuk e zëvendësojnë mandatin individual të deputetit. Edhe kur një parti ka arritur marrëveshje për mënyrën se si duhet të votohet, deputeti, në ushtrimin e mandatit të tij, vendos vetë se si do të votojë në Kuvend. Kushtetuta, Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit dhe Rregullorja e Kuvendit e ndërtojnë pozitën e deputetit mbi parimin e mandatit të lirë. Pra, deputeti është përfaqësues i popullit, dhe nuk i nënshtrohet mandatit detyrues, ndërsa ligji përcakton se gjatë mandatit ai i nënshtrohet ndërgjegjes së tij, thotë Naim Jakaj, hulumtues i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD). “Kjo do të thotë se marrëveshja politike e partisë ka peshë politike, por nuk e eliminon të drejtën e deputetit për të marrë qëndrim individual për një çështje që votohet në Kuvend. Partia mund të kërkojë që deputetët e saj ta mbështesin një qëndrim të caktuar, por vendimi përfundimtar në

Kuvend mbetet i deputetit”, shprehet Jakaj për REL-in. Abit Hoxha, ligjërues dhe hulumtues në Universitetin e Agderit në Norvegji, thotë se nuk mund të fajësohen gjashtë deputetë të caktuar për ushtrimin e të drejtës së tyre për mendim të pavarur si përfaqësues të popullit. “Njëra prej pushteteve që demokracia jonë i jep opozitës, ose një pakice ndaj shumicës, është mekanizmi i kuorumit, i cili nuk është jokushtetues. Është pikërisht ajo çfarë e definon kushtetutshmërinë e Republikës së Kosovës si demokraci e re”, thotë Hoxha për REL-in.

Pse përgjegjësia s'mund të jetë juridike

Jakaj thekson se për këta gjashtë deputetë mund edhe të ketë përgjegjësi politike për mosrealizimin e një marrëveshjeje ndërmjet partive, por jo kushtetuese ose juridike. “Nëse një pjesë e deputetëve të LDK-së nuk e mbështet kandidatin, kjo mund të krijojë

problem politik për partinë që ka hyrë në marrëveshje, por nuk do të thotë se vetëm ata janë përgjegjës për dështimin eventual të zgjedhjes së Presidentit”, thekson ai. Përveç gjashtëshes së LDK-së - Avdullah Hoti, Hykmete Bajrami, Arben Gashi, Armend Zemaj, Kujtim Shala dhe Janina Ymeri - janë edhe të paktën 40 deputetë të tjerë nga partitë parlamentare shqiptare dhe nga komuniteti serb që nuk kanë shprehur mbështetje publike për kandidaturën e Sejdiut. Një pjesë e gjashtëshes së LDK-së është arsyetuar se nuk dëshiron t'i japë “më shumë pushtet Kurtit”, partia e të cilit i fitoi zgjedhjet e 7 qershorit dhe llogaritet t'i ketë numrat për ta bërë Qeverinë e re, ndërsa një pjesë tjetër ka thënë se nuk e sheh Sejdiun si figurë unifikuese. Hoxha thekson se mekanizmi që siguron demokracinë më reprezentative edhe e siguron mendimin e pavarur të deputetëve të Kosovës, ua mundëson përfaqësuesve të popullit të votojnë ashtu qysh ata dëshirojnë vet. “Përndryshe, do të ishte tirania e shumicës”, nënvizon ai. Kosova rrezikon të hyjë në një gjendje të paprecedentë të vakumit kushtetues dhe, në planin institucional, në një formë anarkie, nëse deri më 4 tetor nuk zgjidhet presidenti i ri,

paralajmëron Jakaj. Kjo, sipas tij, e rrit përgjegjësinë politike të të gjithë aktorëve për të gjetur zgjidhje, por nuk e ndryshon pozitën kushtetuese të deputetit dhe nuk krijon detyrim juridik që ai të votojë për një kandidat të caktuar.

A mund ta ndëshkojë LDK-ja gjashtëshen kundërshtuese?

Duke i kritikuar se “po e dërgojnë vendin në zgjedhje”, Abdixhiku kishte paralajmëruar edhe “pasoja” për gjashtë anëtarët e partisë, madje duke lënë të kuptohet se ata duhet ta “dorëzojnë mandatin e deputetit”. Sipas Jakajt, marrëdhënia e deputetit me partinë duhet të ndahet qartë nga statusi i tij kushtetues në Kuvend. Megjithatë, thotë ai, masat partiake nuk mund të prodhojnë si pasojë humbjen e mandatit parlamentar vetëm për shkak se deputeti ka votuar ndryshe nga qëndrimi i partisë. “Mandati i deputetit përfundon në rastet e përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj, jo me vendim të organeve partiake. Prandaj, çdo masë e brendshme duhet të vlerësohet duke pasur parasysh kufirin ndërmjet disiplinës së partisë dhe autonomisë kushtetuese të deputetit në ushtrimin e mandatit”, sipas tij.

LUMIRI I ALBINIT



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Belesh kryetar: Asnjë kryetar i as secilës parti politike në Kosovë nuk ka ardhur në krye të saj aq pameritueshëm sa që është Lumir Abdixhiku në krye të LDK-së. Pa asnjë kontribut politik u katapultua si kryetar, pa asnjë kontribut kombëtar në të kaluarën, të tashmen e mos të flasim për të ardhmen. “Aristokrat” i vetëshpifur, snob i ulët, aspak solidar me pjesën dërrmuese të qytetarëve që vuajnë të zitë e ullirit t’i paguajnë faturat dhe ta sigurojnë mbijetesën në kohën kur ai luan në piano dhe reklamon fruta ekzotike si avokado e të tjera. Me “Vejushën e Zezë”, antikombëtare e operuar nga të gjithë skrupujt kur bëhet fjalë për poste dhe pushtet, Vjosa Osmani, janë shndërruar në rrogëtarë dhe servilë të Kurthit në rrugën e tij drejt shkatërrimit përfundimtar dhe të pakthyeshëm të Kosovës.

Thirren se janë rugovistë, lidhje me Rugovën nuk kanë përveç se e keqpërdorin për vota. Lumir Abdixhiku betejën politike e ka bërë me opozitën (PDK, Aleanca, mediat e lira, opinionistët e pavarur dhe pjesën e LDK-së që nuk ia kruan bishtin) se kundër LV-së. Në fakt kundër LV-së gjithmonë i ka pasur poturet e lëshuara për toke. Bëri e ç’bëri, me llaskuçët brenda partisë dhe e ktheu Vjosa Osmanin apo mojsigolemknë e LDK-së, pas tradhtisë që kjo bukëshkalë i bëri LDK-së duke ia përgjysmuar forcën politike dhe duke ia dërguar si “pajë” martesore gjysmën e deputetëve të LDK-së, shkatërruesit të Kosovës, Albin Kurthit. Bashkë me injoranten Donika Shvarc. Deri në kohën kur Kurthi e shqelmoi pa asnjë konsideratë dhe pa pikë mëshire përkundër servilosjes së pafund të kësaj mercenareje të paskrupullt. LDK-ja gaboi rëndë kur e pranoi renegaten Osmani përsëri duke e bërë bartëse të listës. Këtë e bëri servili i Kurthit, Lumir Abdixhiku, me mashtrim i mbijetuar gjatë dy kuvendeve të jashtëzakonshme. Qëllimi i Abdixhikut ishte të rehatohet në grazhdin politik dhe financiar të Kurthit ndërsa partinë ta lë në duart e renegates Osmani e që

do të shndërrohej në paçavër të Kurthit. Abdixhiku dhe Osmani sikur edhe Kurthi me mercenarët institucionalë nuk e duan UÇK-në, të burgosurit politikë dhe vlerat e vërteta kombëtare. Ata i urrejnë, hapur dhe fshehur duke i goditur mbi brez e nën brezë. Duke i luftuar ulët dhe ndyrë. Këta duan vetën pushtetin dhe të mirat që ia mundëson. Janë të poshtër dhe mashtrues, josakrifikues për lirinë dhe shtetin, përfitues të pamoralshëm nga liria e pamerituar dhe shteti që e dhunojnë çdo ditë. Abdixhiku luftën kryesore e ka me Përparim Ramën, i cili ia fitoi LDK-së Prishtinën në dy mandate dhe kundër secilit brenda LDK-së që kundërshton që LDK-ja të bëhet servil apo kondom i shqyer i LV-së dha hamshorit paranojak, Albin Kurthi. Tash i kërcënon 6 deputetë të LDK-së që nuk e votuan favoritin e Kurthit dhe Vjosa Osmanit për president “konsensual” ndërsa që Bekim Sejdiu është i propozuar nga Vjosa Osmani, me rekomandim dhe pajtim të Kurthit. Realisht dhe nominalisht, Lumir Abdixhiku është kryetar i LDK-së ndërsa faktikisht Vjosa Osmani është alfa dhe omega e LDK-së. Bashkë me Kurthin kjo “politikane” e paskrupullt, LDK-në e kanë shndërruar në teatër

të kukullave. Rugova ishte e kundërta e tyre sepse ishte bashkëpunues me të gjithë akterët politikë dhe asnjëherë nuk e donte tërë pushtetin. Në Rambuje i dha përparësi Hashim Thaçit, bëri koalicion me Ramush Haradinajn dhe Hashim Thaçin, për interes të qytetarit dhe shtetit. Për bindjen time shumë më afër dhe më të vërtetë si rugovistë janë 6 deputetët që po pushkatohej nga Lumiri, Vjosa dhe Albini se mercenarët e Kurthit, Lumir Abdixhiku dhe Vjosa Osmani. Dhe, pa asnjë dyshim, LDK-ja, me Lumir Abdixhikun dhe Vjosa Osmanin nuk ka asnjë alternativë përveç të përfundojë si mendermethënë “Guxo” dhe “Alternativa”. Ndërkaq që Lumiri dhe Vjosa të integrohen me Donikën, Peculken, Agim injorantin, Ardiana taraluzhën, Avni marionetën, shkartovinën Lenkë dhe të tjerë. **Pushkatimi i paskrupullt i Blerim Isufajt:** Dy herë jam dënua para gjykatave të ish Jugosllavisë. Herën e parë në Sarajevë me tre vjet burg dhe herën e dytë para Gjykatës Ushtarake në Zagreb me 12 vjet burg. Afërsisht 6 vjet kam qenë në vetmi dhe izolim. Vetëm unë me Zotin. Herën e parë më kanë marrë në pyetje inspektorët e sigurimit të shtetit jugosllav, kurse herën e dytë më kanë

marrë më pyetje oficerët e shërbimit të zbulimit dhe kundërzbulimit të ushtrisë jugosllave - KOS. Herën e parë jam arrestuar me kërkesë të Xhevdet Hamzës, gjyshi i Agon Hamzës, këshilltar aktual i Albin Kurthit. Agon Hamza ishte nën çebe në veturën e ndaluar nga policia në Klinë bashkë me Kurthin, Dardan Velinë dhe Vlora Bajçinovcin e që shoqëroheshin nga vëllezërit Donçiq, oficerë të BIA-së. Për lexuesit e nderuar dua të theksoj se në të dyja rastet kur jam marrë në pyetje dhe trajtuar nga inspektorët e sigurimit të shtetit dhe të KOS-it, jam trajtuar më me dinjitet se që është trajtuar Blerim Isufaj nga Këshilli Prokurorial i Dejana Mihalit, simotër e Fatmir Shehollit. Gjatë hetimeve më kanë trajtuar si armik por më kanë respektuar si kundërshtar që kam mbrojtur qëndrimin tim dhe që nuk kam pranuar asgjë nga ta. Përkundër 6 viteve të vetmisë. Histeria gjatë marrjes në pyetje të Blerim Isufajt - jo dëgjim të raportimit të një kolegu dhe udhëheqësi është patologji në vete, është degradim i skajshëm i moralit, njerzillëkut dhe profesionalizmit. Është turp dhe poshtërsi! Pastaj heshtja jonë! Është kryevepër e turpiti!

DEHARI CAKTON 9 SHTATORIN PËR VAZHDIMIN E SEANCËS KONSTITUIVE TË KUVENDIT TË KOSOVËS

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Deputetët e zgjedhur pritet të mblidhen më 9 shtator për vazhdimin e seancës konstitutive të Kuvendit të Kosovës, në përpjekje për t’i formuar institucionet e reja të vendit pas zgjedhjeve të qershorit dhe për t’i dhënë fund krizës pothuajse dyvjeçare politike. Kryesuesi i seancës, Avni Dehari, njoftoi të premten se ka vendosur që seanca e mbetur në gjysmë muajin e kaluar të vazhdojë të mërkurën në orën 11:00. Ai tha se e mori këtë vendim pas arritjes së një marrëveshjeje të brishtë politike mes Lëvizjes Vetëvendosje të

kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës në opozitë, për kandidatin për president të Kosovës. “Edhe pse ende nuk ka qartësi të plotë, nëse ekziston numri i nevojshëm i deputetëve për konstituimin e të gjitha institucioneve, kam vendosur që vazhdimin e Seancës Konstitutive ta thërras më 9 shtator, në orën 11:00”, tha Dehari në “Facebook”. Zgjedhja e presidentit të ri të vendit është në qendër të krizës politike tani, pasi kërkohet një marrëveshje politike mes pushtetit dhe opozitës për t’i siguruar votat e nevojshme.



Kurti viziton Doganën: Të hyrat janë rritur 6 %, arrijnë në 1 miliard e 347 milionë euro

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, i shoqëruar edhe nga ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, ka vizituar Doganën e Kosovës. Kurti është pritur nga drejtori i Doganës, Agron Llugaliu. “Me 1 miliard e 347 milionë euro të hyra deri tani apo 6 % më shumë sesa vitin e kaluar, Dogana e Kosovës po vazhdon me rritjen e pandërprerë dhe të ndjeshme të performancës. Nga viti 2021 deri më 2025, rritja mesatare e të hyrave ka tejkaluar gati trefish normën e rritjes ekonomike,

periudhë gjatë së cilës janë arkëtuar gjithsej 8 miliardë e 380 milionë euro”, ka thënë Kurti, duke shtuar se paralelisht janë ndërmarrë reforma të rëndësishme për lehtësimin e veprimtarisë së bizneseve, përfshirë përmbylljen e shtetëzimit të terminaleve doganore dhe zbatimin e deklarimit të mallrave para arritjes, i cili ka kontribuar në reduktimin e kohës së procesimit me rreth 70 për qind. “Krahas shtimit të efikasitetit në mbledhjen e të hyrave, Dogana ka forcuar edhe kontrollet



kufitare dhe përdorimin e teknologjisë. Funksionalizimi i skanerit në Merdarë ka rritur kapacitetet për identifikimin dhe parandalimin e kontrabandës dhe aktiviteteve të paligjshme. Në vijimësinë e modernizimit, po përparojnë edhe projekte të reja strategjike, përfshirë Dritaren e Vetme Kombëtare, Tranzitin e Përbashkët, automatizimin e mëtejme të proceseve dhe forcimin e kapaciteteve teknologjike të Doganës së Kosovës”, ka thënë Kurti pas kësaj vizite.

Haradinaj nga "Hardh Fest": Rahoveci vazhdon ta ruajë traditën dhe ta promovojë vreshtarinë e verën

RAHOVEC, 4 SHTATOR - Deputeti i Aleancës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë në nisjen e "Hardh Fest 2026" në Rahovec, duke vlerësuar traditën, punën e vreshtarëve dhe rëndësinë e kësaj komune për zhvillimin e vreshtarisë dhe promovimin e verës së Kosovës. Haradinaj ka thënë se Karnavali i Vreshtarëve, prerja ceremoniale e kalaveshit dhe garat në vjeljen e rrushit shënojnë fillimin e një feste që

çdo vit mbledh fermerë, artdashës dhe vizitorë nga vendi e më gjerë. Ai ka vlerësuar punën e fermerëve, mbështetjen e kryetarit të Rahovecit, Smajl Latifi, dhe të komunës së Rahovecit, si dhe angazhimin e Rustem Gecajt dhe organizatorëve të festivalit për ruajtjen dhe promovimin e traditës së vreshtarisë. Në këtë kuadër, Haradinaj ka theksuar edhe nevojën për zbatimin e planit të Aleancës

për zhvillimin ekonomik të vendit. Sipas tij, ndër masat që duhet të ndërmerren janë ngritja e pragut të TVSh-së nga 30 mijë në 100 mijë euro për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, lirimi i tokës së punuar nga tatimi në pronë dhe pagesa e subvencioneve për bujqit pa vonesa. "Rahoveci vazhdon ta ruajë traditën dhe ta promovojë vreshtarinë e verën", ka shkruar Haradinaj në një postim në rrjetet sociale.



VALDETJA, SHEMBULLI I QËNDRESËS DHE PAJTIMIT

Lulëzim ETEMAJ

Sot shënohet 22-vjetori i ndarjes së hershme nga jeta të Valdete Fejzullahit (1972-2004), veprimtares nga Gostivari që jetën e saj të shkurtër e lidhi me idealet e lirisë, pajtimit dhe bashkimit rreth çështjes kombëtare. Valdetja ishte ndër pjesëtarët e para të grupit të rinjve nga Tetova dhe Gostivari që në fillimet e saj mbështetën Lëvizjen e Pajtimit të Gjaqeve në Kosovë 1990-1991. Për një brez të tërë shqiptarësh, kjo lëvizje nuk ishte thjesht një përpjekje për t'i dhënë fund hasmërive ndërmjet familjeve, por një përpjekje e gjerë shoqërore për të mbyllur plagët e vjetra dhe për t'i bashkuar njerëzit në një periudhë të rënd të historisë sonë kombëtare, si parakusht i domosdoshëm për të filluar luftën e armatosur çlirimtare. Në këtë angazhim, Valdetja dha



kontributin e saj me një përkushtim që merr edhe më shumë peshë kur kujtohet fakti se sapo kishte dalë nga burgu, ku kishte vuajtur dënimin politik. Ende nuk kishin kaluar mbi dy muaj nga lirimi i saj, por ajo nuk zgjodhi të tërhiqej për t'u marrë me jetën dhe hallet e veta. Përkundrazi, iu kthye menjëherë veprimtarisë.

Një nga ngjarjet më të rëndësishme ku ajo u angazhua ishte tubimi madhështor i 28 korrikut 1990 në "Rudinën e Pajtimit", pranë Malit të Thatë, në Çegran të Gostivarit. Pavarësisht pengesave dhe ndjekjeve nga policia maqedonase, aty u mbledhën mbi 50 mijë pjesëmarrës. Në këtë tubim u

promovua shtrirja e dorës së pajtimit nga nëntë familje: u falën tri gjaqe dhe gjashtë ngatërresa. Sot, kujtimi për Valdeten nuk duhet të mbetet vetëm një përkujtim i përvjetorit. Ajo meriton më shumë se një emër rrugë në Tetovë, Gostivar apo Prishtinë. Historia e saj duhet


të ruhet, të dokumentohet dhe t'u përcillet brezave të rinj si pjesë e kujtesës sonë historike. Valdetja mbetet shembull i një brezi që, edhe pas burgut politik, zgjodhi përkushtimin, pajtimin e bashkimit, luftën çlirimtare dhe sakrificën. Prehje në paqe, bijë e denjë e Gostivarit!



SHKOLLAT KATËR DITË PA DITARË, AVONET KËRKON PËRGJEGJËSI NGA MINISTRIA E ARSIMIT

PRISHTINË, 4 SHTATOR - AVONET ka shprehur shqetësimin për mungesën e ditarëve shkollorë në shkollat e Republikës së Kosovës edhe në ditën e katërt pas fillimit të vitit të ri shkollor. Sipas rrjetit të OJQ-ve AVONET, ditari shkollor përbën një nga mjetet bazë për evidentimin, dokumentimin dhe administrimin e procesit mësimor. AVONET vlerëson se fakti që mësimdhënësit, disa ditë pas fillimit të mësimin, nuk kanë në

dispozicion këtë mjet bazë pune, është i papranueshëm dhe ngre pikëpyetje serioze mbi planifikimin dhe koordinimin institucional. "Katër ditë pa një mjet bazë të punës janë tregues i një dështimi në planifikim dhe koordinim institucional", thuhet në reagimin e organizatës AVONET-it, e cila ngre një sërë pyetjesh ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, duke kërkuar të dijë pse ditarët nuk janë siguruar dhe shpërndarë para fillimit të



procesit mësimor dhe kush mban përgjegjësi për këtë vonesë. AVONET konsideron se mungesa e ditarëve nuk duhet të trajtohet si një çështje e

zakonshme administrative apo si një vonesë e parëndësishme. "Është e pakuptimtë që në Kosovë të flitet për reforma të thella në arsim, digjitalizim, rritje të cilësisë dhe modernizim të sistemit arsimor, ndërkohë që shkollat përballen me mungesën e mjeteve elementare për zhvillimin dhe dokumentimin e procesit mësimor", thekson organizata. AVONET kërkon nga Ministria e Arsimit që urgjentisht të japë

një sqarim publik për arsyen e mungesës së ditarëve, masat e ndërmarra për furnizimin e shkollave, afatin konkret kur të gjitha institucionet arsimore do të pajisen me to, si dhe përgjegjësinë institucionale për këtë situatë. Kjo organizatë thekson se nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit nuk meritojnë arsyetime, por institucione të përgjegjshme, të organizuara dhe të gatshme për të përmbushur detyrimet e tyre në kohë.

ATK dhe Dogana forcojnë bashkëpunimin kundër ekonomisë joformale

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Administrata Tatimore e Kosovës, në bashkëpunim me Doganën e Kosovës, së shpejti do ta nisë zbatimin e Planit të Përbashkët të Veprimit për luftimin e ekonomisë joformale. Plani synon forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe koordinimin e kontrolleve të përbashkëta në terren, me fokus

në fushat me risk dhe interes të përbashkët, duke mundësuar ndjekjen e zinxhirit ekonomik nga importi dhe qarkullimi i mallrave deri te shitja dhe konsumi në tregun e brendshëm. Gjatë vitit 2025 bashkëpunimi ndërmjet ATK-së dhe Doganës së Kosovës ka rezultuar në 19 kontrolle të përbashkëta në terren dhe në evidentimin e

shmangieve nga detyrimet tatimore dhe doganore në vlerë prej 1.6 milion euro. Duke u bazuar në këto rezultate dhe në sfidat e identifikuar, plani i ri synon të rrisë më tej efikasitetin e kontrolleve dhe t'i forcojë mekanizmat për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale. Në këtë kuadër, zbatimi i Planit

të Përbashkët të Veprimit synon që kontrollet të orientohen më saktë drejt rasteve me risk, të rritet shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve dhe të sigurohet një mbikëqyrje më e plotë e aktivitetit ekonomik. Përmes këtij mekanizmi, ATK dhe Dogana e Kosovës synojnë të ndërhyjnë në mënyrë më të



koordinuar aty ku evidentohen parregullsi, duke parandaluar humbjet në të hyra publike dhe duke siguruar zbatimin e njëjtë të rregullave për të gjithë operatorët ekonomikë.

HULUMTIMI I CASA-S: 99 PËR QIND E SERBËVE NË KOSOVË KUNDËR INTEGRIMIT TË SISTEMIT ARSIMOR

Integrimi i mundshëm i sistemit arsimor serb në Kosovë duhet të përkufizohet si njohje ligjore dhe institucionale dhe jo si asimilim, duhet të sigurohet qartësi ligjore para çdo ndryshimi të mundshëm të statusit, të sigurohet koordinim thelbësor me komunitetin serb të Kosovës dhe të shmangen masat e njëanshme. Këto janë disa nga rekomandimet që dalin nga hulumtimi “Pyetjet e vështira që kemi përpara: Sistemi arsimor i serbëve të Kosovës”, i realizuar nga organizata joqeveritare Qendra për Veprime Shoqërore Afirmative (CASA).

Hulumtimi, siç u tha, është realizuar me një mostër prej 500 pjesëtarësh të komunitetit shqiptar dhe 300 pjesëtarësh të komunitetit serb, me qëllim që të hapë një debat të bazuar në fakte për disa nga “çështjet më të ndjeshme dhe politikisht më të diskutueshme që ndikojnë në marrëdhëniet mes serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës”.

Ndër gjetjet kryesore të hulumtimit është se integrimin e mundshëm të institucioneve arsimore serbe e kundërshtojnë gjithsej 99.4 për qind e të anketuarve nga radhët e komunitetit serb. Ndërsa, 98.7 për qind e tyre vlerësuan se integrimi do të kishte ndikim negativ në pozitën e komunitetit serb, kurse mbi 90 për qind e të anketuarve zgjodhën vazhdimin e funksionimit të shkollave dhe universitetit në sistemin e Serbisë, si skenarin më të pranueshëm.

Gjithashtu, më shumë se gjysma e të anketuarve, rreth 56 për qind, thanë se nuk do ta mbanin fëmijën e tyre në një shkollë që pas integritetit të sistemit arsimor serb në atë të Kosovës.

Nga ana tjetër, rreth 52 për qind e të anketuarve nga radhët e komunitetit shqiptar kanë qëndrim neutral sa i përket asaj nëse ndarja e sistemeve arsimore ndikon në marrëdhëniet ndëretnike. Gjashtëdhjetë për qind e të



anketuarve thanë se janë pak ose aspak të informuar për përmbajtjen e mësimin në shkollat që funksionojnë në sistemin e Serbisë, ndërsa 41 për qind e të anketuarve kanë qëndrim neutral ndaj integritetit.

Ndryshe, çështja e integritetit të shëndetësisë dhe arsimit serb në Kosovë u ngrit në shtator të vitit të kaluar, kur kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, tha se sistemi i dyfishtë i arsimit nuk është i qëndrueshëm dhe se nevojitet inkorporim dhe bashkim në një sistem unik. Bashkimi Evropian, i cili ndërmjetëson dialogun mes Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve, më herët i kishte thënë Radios Evropa e Lirë se statusi i strukturave dhe shërbimeve shëndetësore e arsimore që Serbia i mbështet në Kosovë do të zgjidhet përmes negociatave në Bruksel, në përputhje me marrëveshjet e arritura dhe ligjet në fuqi të Kosovës.

Për integrimin e shëndetësisë dhe arsimit në përputhje me Marrëveshjen e Brukselit këmbëngul edhe Beogradi zyrtar, si dhe Lista Serbe,

partia më e madhe e serbëve në Kosovë, e cila gëzon mbështetjen e pushtetit aktual në Serbi.

Organizata joqeveritare CASA, në raportin e saj, rekomandon që si zgjidhje e mundshme për këtë çështje të shqyrtohet roli i Asociacionit të komunave me shumicë serbe, për të cilin palët janë pajtuar në kuadër të dialogut të Brukselit.

“Çdo zgjidhje e ardhshme duhet të bazohet në elementet për të cilat tashmë është arritur marrëveshje në kuadër të dialogut, duke përcaktuar njëkohësisht mekanizma shtesë të nevojshëm për të siguruar koherencën funksionale dhe territoriale të sistemit arsimor të serbëve të Kosovës”, thuhet në raport.

Miodrag Marinković nga CASA tha më 3 shtator, gjatë prezantimit të hulumtimit, se integrimi i mundshëm i sistemit arsimor serb nuk përbën asimilim dhe se është e rëndësishme të shmangen masat e njëanshme dhe të komunikohet me komunitetin serb. “Kur flitet për integrim, serbët e kuptojnë atë si asimilim, gjë që nuk është kështu, por ata kështu e perceptojnë integrimin. Kjo

çështje mund të shkaktojë migrim masiv brenda komunitetit serb dhe për këtë arsye është e nevojshme që ky proces i ndjeshëm të zhvillohet përmes një dialogu gjithëpërfshirës”, theksoi Marinković.

Politologu Ognjen Gogić, i cili e realizoi hulumtimin në mesin e komunitetit serb, tha se rezultatet treguan se integrimi i mundshëm i institucioneve arsimore serbe në sistemin e Kosovës do të ndikonte drejtpërdrejt te nxënësit, studentët, prindërit dhe punonjësit, si dhe në vazhdimin e shkollimit, njohjen e kualifikimeve, lidhjet institucionale me Serbinë dhe ndjenjën më të gjerë të sigurisë së komunitetit serb në Kosovë.

Perspektivën e shqiptarëve të Kosovës për integrimin e arsimit në gjuhën serbe e prezantoi Ramadan Ilazi nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, i cili tha se shumica e të anketuarve konsiderojnë se nxënësit dhe studentët e nacionalitetit serb duhet të kenë mundësi të arsimohen në gjuhën e tyre amtare, por ekskluzivisht brenda sistemit ligjor dhe rregullativ të

Kosovës.

Ai vuri në dukje se kuadri ligjor i Kosovës tashmë mundëson arsimimin në gjuhën serbe, si dhe zbatimin e planeve dhe programeve mësimore të marra nga Serbia, me kusht që ato të miratohen nga Ministria e Arsimit e Kosovës. “Ajo që kuadri ekzistues ligjor nuk parashikon është ekzistenca e një sistemi arsimor që funksionon tërësisht jashtë kompetencave institucionale dhe kuadrit ligjor të Kosovës”, tha ai.

Ilazi përmendi gjithashtu se Plani i Ahtisarit, dokumenti mbi bazën e të cilit u shpall pavarësia e Kosovës, parasheh që komunat e banuara me shumicë serbe të kenë kompetenca të zgjeruara në fushën e kujdesit shëndetësor sekondar dhe arsimit të lartë. Vendet përëndimore deri më tani kanë mbajtur kryesisht qëndrimin se të gjitha institucionet serbe duhet të integrohen në sistemin e Kosovës, përfshirë ato shëndetësore dhe arsimore, por se kjo duhet të bëhet në konsultim me komunitetin serb dhe përmes Asociacionit të komunave me shumicë serbe.

Azemi: Punëtorët teknikë nuk kthehen në punë pa pagat e korrikut dhe gushtit

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve Teknikë, Jusuf Azemi, ka thënë se greva në Prishtinë do të vazhdojë derisa punëtorëve t'u paguhen pagat e prapambetura. Duke folur në “Ora 7” në “Klan Kosova”, Azemi tha se punëtorët po

përballen me presion për t'u kthyer në shkollë. “Pa e paguar komplet muajin gusht dhe ditët e muajit korrik ne nuk do t'i kthehemi punës”, deklaroi ai. Azemi tha se sindikata është tërhequr nga marrëveshja e mëhershme me DKA-në, duke e akuzuar këtë të fundit për

mosrespektim të marrëveshjes. Ai kërkoi që punëtorëve t'u garantohet paga prej 500 eurosh, duke shtuar se nuk do të ketë më bisedime me institucionet derisa të paguhen pagat e korrikut e gushtit dhe të zbatohet paga prej 500 eurosh.



FERMERËT SHOHIN KTHESË NË TREGUN E QUMËSHTIT

Fermerët thonë se qumështi i freskët po gjen më lehtë treg pas masave që kufizuan përdorimin e vajit të palmës dhe qumështit pluhur. Vlera e importeve të vajit të palmës dhe qumështit pluhur ka rënë, ndërsa të dhënat e Shoqatës së Prodhuesve të Qumështit tregojnë rritje të sasisë së qumështit të shitur nga fermerët. Industria mbetet më e kujdesshme: kërkesa nuk është rritur ndjeshëm dhe disa kompani përballen me stoqe të pashitura

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Vetëm disa muaj më parë fermerët në Kosovë thoshin se deri në 30 për qind e qumështit të freskët u mbetej pa shitur - problem që ata e lidhnin, ndër të tjera, me konkurrencën nga produktet e prodhuara me qumësht pluhur dhe yndyrë bimore.

Sot pas masave të qeverisë për kufizimin e përdorimit të këtyre produkteve në industrinë e qumështit disa fermerë thonë se tregu ka nisur të stabilizohet. Edhe të dhënat e Shoqatës së Prodhuesve të Qumështit, të siguruar nga Radio Evropa e Lirë, tregojnë rritje të sasisë së qumështit të shitur nga fermerët. Në periudhën janar-qershor të këtij viti, nga fermerët bashkëpunues të Shoqatës janë grumbulluar dhe shitur mbi 45 milionë litra qumësht, krahasuar me rreth 35 milionë litra në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Vlera e importeve të vajit të palmës dhe qumështit pluhur ka rënë, po ashtu.

Nga qumështi pa treg te planet për zgjerim

Arbnor Binakaj, fermer nga rrethina e Gjakovës, mban rreth 40 lopë dhe prodhon 270 deri në 300 litra qumësht në ditë.

Në vitet e kaluara, thotë ai, pasiguria nëse do të arrinte ta shiste qumështin e kishte penguar të investonte në zgjerimin e fermës.

Tani situata i duket ndryshe. “Ne kemi pasur kriza të herëpashershme dhe mungesë të tregut për qumështin. Ka shenja për stabilitet, nuk ka qumësht që mbetet pa u shitur. Tani do t’i rris edhe investimet dhe kapacitetet prodhuese, sepse vaji i palmës dhe qumështi pluhur, deri tash, e kanë zëvendësuar produktin tonë të freskët”, thotë Binakaj për Radion Evropë e Lirë.

Ai planifikon ta zgjerojë fermën nga 40 në 100 krerë lopë, por thotë se investimi do të varet edhe nga vazhdimësia dhe zbatimi i masave. “Qeveria nuk duhet të heqë dorë nga masat e ndërmarrja, sepse ato sjellin siguri, vizion dhe qëndrueshmëri për fermerët”, thotë Binakaj. Ndryshim pret edhe Xhevdet Morina, fermer nga Rogova e Hasit, i cili ka rreth 70 lopë dhe prodhon deri në 900 litra qumësht në ditë.

Por, sipas tij, vetëm kufizimi i përdorimit të vajit të palmës dhe qumështit pluhur nuk mjafton. Ai thotë se konsumatorët duhet ta kenë të qartë se çfarë produkti

blejnë. “Në markete, gjithsesi, duhet të bëhet ndarja dhe etiketimi i qartë mes produkteve me yndyrë bimore dhe atyre me yndyrë shtazore, në mënyrë që konsumatori ta dijë se çfarë blen”, thotë Morina për Radion Evropë e Lirë.

Çfarë ndryshoi qeveria?

Masat erdhën pas ankesave të fermerëve se një pjesë e konsiderueshme e qumështit të freskët nuk po gjente treg.

Më 28 prill, Ministria e Bujqësisë vendosi një paketë kufizimesh për tregun e qumështit, me synim mbrojtjen e prodhimit vendor dhe konsumatorëve.

Masat përfshijnë kategorizimin dhe etiketimin më të qartë të produkteve, ndalimin e përzierjes së qumështit të freskët me produkte që përmbajnë qumësht pluhur apo vaj palme, si dhe kontrolle dhe analiza laboratorike.

Për qumështin pluhur u vendos edhe akcizë.

Masat nuk nënkuptojnë se çdo produkt që përmban yndyrë bimore ose qumësht pluhur është i ndaluar përgjithmonë nga tregu. Operatorët që i përdorin këta përbërës, duhet t’i plotësojnë kërkesat e reja për licencim, kategorizim dhe deklarim, ndërsa produktet nuk mund të tregtohen si produkte tradicionale të qumështit nëse përbërja e tyre nuk e justifikon një emërtim të tillë.

Kontrollet që pasuan, nxorën në pah mospërputhje në treg. Në fillim të gushtit, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) njoftoi se rreth 20 për qind e mostrave të analizuarat të produkteve të qumështit kishin mospërputhje ndërmjet përbërjes së produktit dhe asaj që deklarohet në etiketë.

Shumica e rasteve kishin të bënin me praninë e vajit të palmës pa u deklaruar.

Sipas AUV-it, operatorët që përdorin vaj palme ose qumësht pluhur, duhet të pajisen me licenca të veçanta, ndërsa produktet e tilla nuk mund të tregtohen me emërtimet tradicionale si “qumësht”, “djathë”, “gjizë” apo “krem”.

Pas këtyre masave, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) nisi kontrolle në markete, depo dhe tek importuesit e shitësit me shumicë e pakicë.

Bizneset u obliguan t’i largonin nga raftet produktet për të cilat organet kompetente kishin



konstatuar mospërputhje.

Radio Evropa e Lirë kërkoi nga MINTI të dhëna për sasinë e produkteve të larguara nga tregu, por Ministria nuk iu përgjigj kësaj kërkesë.

Në raftet e disa marketeve, ndërkohë, vërehet se disa produkte të qumështit që më parë ishin në shitje, nuk gjenden më.

Më pak vaj palme dhe qumësht pluhur nga importi

Një tjetër sinjal për ndryshimet në treg vjen nga Dogana e Kosovës. Të dhënat për periudhën janar-korrik tregojnë se vlera e importeve të vajit të palmës dhe qumështit pluhur ka rënë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Gjatë shtatë muajve të parë të këtij viti, Kosova importoi vaj palme në vlerë prej rreth 2.3 milionë eurosh, krahasuar me rreth 3 milionë euro gjatë së njëjtës periudhë të vitit 2025.

Rënia e vlerës bëhet më e dukshme nga maji.

Vetëm gjatë periudhës maj-korrik, vlera e importit të vajit të palmës ishte rreth 270 mijë euro më e ulët se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Por, këto të dhëna nuk dëshmojnë se rënia është shkaktuar nga masat e Qeverisë.

Vaji i palmës përdoret jo vetëm në produkte ushqimore, por edhe në industri të tjera, përfshirë atë kozmetike.

Për këtë arsye, ndryshimi i importit të tij të përgjithshëm nuk mund t’i atribuohet vetëm sektorit të qumështit.

Përndryshe, rënie të vlerës ka shënuar edhe importi i qumështit pluhur.

Nga rreth 1.8 milion euro gjatë shtatë muajve të parë të vitit 2025, ajo ka zbritur në rreth 1.3 milion euro gjatë së njëjtës periudhë të këtij viti.

Fermerët optimistë, industria më e kujdesshme

Naser Bajraktari, kryetar i Shoqatës së Prodhuesve të

Qumështit, pret që masat ta lehtësojnë problemin e fermerëve me plasimin e qumështit të freskët.

Sipas tij, kufizimi i përdorimit të vajit të palmës dhe produkteve alternative në qumështore pritet ta rrisë kërkesën për qumësht vendor, ndërsa efektet më të dukshme mund të shfaqen në vazhdim.

Ai thotë se fermerët kanë kapacitete për ta rritur prodhimin dhe për të mbuluar një pjesë më të madhe të nevojave të tregut.

Radio Evropa e Lirë kontaktoi edhe disa kompani përpunuese që përdorin qumështin e freskët si lëndë të parë.

Disa prej tyre, të cilat nuk pranuan të identifikohen, thanë se kanë rritur sasinë e qumështit të freskët që blejnë, por nuk ofruan të dhëna konkrete për sasinë e rritjes.

Të tjerë thanë se kanë ndërprerë përkohësisht prodhimin e disa artikujve, derisa t’i plotësojnë kërkesat për licencim.

Por, atë që fermerët e përshkruajnë si kthesë në treg, industria ende nuk e sheh si trend të konsoliduar.

Gani Durmishi, nga Shoqata e Industrisë së Qumështoreve të Kosovës, thotë se disa kompani, aktualisht, përballen me stoqe të produkteve të pashitura dhe se ende nuk ka rritje të ndjeshme të kërkesës për qumësht të freskët.

Sipas tij, shitja e disa produkteve, të cilat nuk i specifikon, ka rënë deri në 50 për qind.

Durmishi e lidh këtë rënie me perceptimin negativ të krijuar te konsumatorët pas kontrolleve dhe gjetjeve për përbërës të padeklaruar.

Ai kërkon nga AUV-i që ta informojë publikun se cilat produkte vendore i kanë kaluar analizat dhe i plotësojnë standardet e sigurisë, me qëllim që, sipas tij, të rikthehet besimi i konsumatorëve.

Durmishi, po ashtu, konfirmon se disa fabrika kanë pezulluar përkohësisht prodhimin e produkteve të caktuara që përmbajnë vaj palme ose qumësht pluhur, derisa t’i plotësojnë kërkesat e reja për licencim dhe kategorizim. Sipas

tij, problemi kryesor i industrisë nuk është kapaciteti për përpunim, por tregu për produktet e prodhuara.

Industria, thotë ai, ka kapacitet të përpunojë rreth një milion litra qumësht në ditë, ndërsa aktualisht përpunohen deri në 300 mijë litra.

Paradoksi i tregut të qumështit

Pikërisht këtu shfaqet një prej paradokseve të sektorit.

Kosova nuk prodhon mjaftueshëm produkte qumështi për t’i mbuluar nevojat e veta. Industria thotë se punon shumë nën kapacitetet përpunuese.

E, megjithatë, fermerët kanë raportuar se një pjesë e qumështit të freskët nuk arrinte të gjente treg.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë, prodhimi vendor mbulon vetëm rreth 66 për qind të nevojave të tregut, ndërsa pjesa tjetër sigurohet përmes importit. Në vitin 2024, industria e qumështit në Kosovë prodhoi produkte me vlerë prej 135.2 milionë eurosh.

Në të njëjtën kohë, është tkurrur edhe baza e prodhimit vendor.

Në vitin 2024, Kosova kishte 126.549 lopë qumështore - 3.348 më pak se një vit më parë, kur numri i tyre ishte 129.897.

Fermerët e lidhin këtë rënie, ndër të tjera, me pasigurinë shumëvjeçare të tregut.

Për ta nxitur prodhimin, Ministria e Bujqësisë subvencionon fermerët me 90 euro në vit për çdo lopë, si dhe me 2 deri në 7 centë për çdo litër qumësht të prodhuar, varësisht nga cilësia.

Por, fakti që Kosova importon rreth një të tretën e produkteve të qumështit që konsumon, ndërsa fermerët vendorë kanë pasur vështirësi ta shesin prodhimin e tyre, tregon se problemi nuk lidhet vetëm me sasinë e qumështit që prodhohet.

Çmimi, produktet alternative, importet, mënyra se si industria e siguron lëndën e parë dhe aftësia e tregut për t’i absorbuar produktet vendore janë pjesë e një zinxhiri më kompleks.

AMBASADORI GJERMAN: RUSIA PO RRIËT PRESIONIN NDAJ GJERMANISË DHE EUROPËS



Gjermania ka bërë mirë që ka reaguar ndaj veprimeve të Rusisë dhe masat e reja kundër Moskës janë një sinjal i nevojshëm, edhe pse nuk pritet ta bindin presidentin rus Vladimir Putin të ndryshojë qëndrim. Kështu është shprehur ambasadori gjerman Wolfgang Ischinger, president i Konferencës së Sigurisë në Mynih.

Në një intervistë në Romë, Ischinger tha se incidentet si ai me dronin në aeroportin e Leipzigut duhet të merren shumë seriozisht dhe, sipas tij, mund të konsiderohen akte lufte ose terrorizmi.

Pse Gjermania është në shënjestër?

Sipas Ischinger, Gjermania është një nga vendet europiane që ka ndryshuar më shumë politikën e saj ndaj Rusisë. Për vite me radhë, Berlioni kishte investuar shumë në bashkëpunimin ekonomik dhe energjetik me Moskën. Pas nisjes së luftës në Ukrainë, Gjermania ndryshoi politikën e saj, duke vendosur sanksione

ndaj Rusisë dhe duke rritur mbështetjen për Ukrainën. Ischinger tha se Rusia e ka kuptuar se këto ndryshime mund të krijojnë edhe probleme politike për qeverinë gjermane, veçanërisht në pjesën lindore të vendit, ku partia e djathtë AfD ka mbështetje të konsiderueshme dhe kërkon rikthimin e marrëdhënieve me Moskën.

Rusia po rrit nivelin e kërcënimit

Ischinger tha se Rusia ka filluar të synojë gjithnjë e më shumë vendet që kanë rol të rëndësishëm në furnizimin e Ukrainës me ndihma dhe armë. Gjermania, sipas tij, është një nga vendet kryesore në këtë proces.

“Moska dëshiron ta bëjë më të kushtueshme edhe mbështetjen për Kievin”, tha ai. Një pjesë e rëndësishme e strategjisë ruse, sipas Ischinger, është kërcënimi bërthamor. Ai theksoi se Putin dhe zyrtarë të tjerë rusë kanë bërë vazhdimisht deklarata që përmendin mundësinë e

përdorimit të armëve bërthamore. Sipas tij, këto kërcënime kanë një ndikim më të madh në Gjermani, ku një pjesë e opinionit publik është më e ndjeshme ndaj çështjes së armëve bërthamore.

Gjermania duhet të bashkëpunojë më shumë me Europën

Duke folur për rritjen e shpenzimeve gjermane për mbrojtjen, Ischinger tha se Berlioni duhet të shpjegojë më qartë se forcimi i ushtrisë nuk synon rikthimin e fuqisë ushtarake gjermane, por përmbushjen e detyrimeve ndaj NATO-s dhe Bashkimit Europian. Ai propozoi që një pjesë e fondeve të mëdha që Gjermania po investon në mbrojtje të përdoret për projekte të përbashkëta europiane.

Sipas tij, Gjermania duhet të bashkëpunojë veçanërisht me Francën, Italinë, Spanjën dhe vende të tjera për të krijuar një industri europiane më të fuqishme të mbrojtjes.

Ischinger tha gjithashtu se nuk sheh rrezik për rikthimin e militarizmit gjerman, pasi e ardhmja e Gjermanisë, sipas tij, mbetet e lidhur ngushtë me NATO-n dhe Bashkimin Europian.

E5 si bazë për mbrojtjen europiane

Diplomati gjerman mbështet gjithashtu formatin E5, që përfshin Gjermaninë, Francën, Britaninë e Madhe, Italinë dhe Poloninë. Sipas tij, këto pesë vende mund të përbëjnë bazën e një bashkëpunimi më të fortë europian në fushën e mbrojtjes. Ischinger vlerësoi veçanërisht rolin e Italisë, duke theksuar ekonominë dhe industrinë e saj të rëndësishme të mbrojtjes.

Presioni ndaj Rusisë mund ta çojë në negociata

Për luftën në Ukrainë, Ischinger tha se sulmet ruse ndaj infrastrukturës dhe

civilëve po shoqërohen me një rritje të aftësisë së Ukrainës për të goditur objektiva brenda territorit rus.

Sipas tij, nëse Ukraina vazhdon t'i shkaktojë dëme të mëdha Rusisë, kjo mund të rrisë presionin mbi Kremlinin për t'u ulur në tryezën e negociatave. Megjithatë, ai pranoi se në këtë moment Moska nuk duket e gatshme për një marrëveshje.

Europa nuk ka një qasje të koordinuar

Ischinger tha se Europa ende nuk ka një strategji të përbashkët për rolin që duhet të luajë në negociatat për Ukrainën. Ai u shpreh kundër debatit publik se kush duhet të jetë ndërmjetës mes Kievit dhe Moskës, duke argumentuar se diplomacia e qetë dhe larg vëmendjes së publikut mund të jetë më efektive. Sipas tij, përpjekjet e të dërguarve amerikanë për të ndërmjetësuar një marrëveshje mes Rusisë dhe Ukrainës aktualisht kanë ngecur.

‘LUFTË E FTOHTË’ NË BE - PROPOZIMI PËR HEQJEN E VETOS, KALLAS KUNDËR VON DER LEYEN

“Luftë e ftohtë” në BE - Propozimi për heqjen e Vetos fut në “luftë të ftohtë” BE. Propozimi franko-gjerman për të lehtësuar zgjerimin evropian ka ekspozuar luftën për pushtet në Bruksel. Ndryshimi i strukturës së politikës së jashtme të BE është kundërshtuar nga drejtuesja e institucionit kryesor të shërbimit diplomatik evropian, Kaja Kallas. Propozimi franko-gjerman mbështetur tashmë dhe nga 9 shtete të tjera evropiane, synon ta zhbëjë Shërbimin Evropian për Shërbim të Jashtëm për ta lënë vetëm një drejtori nën ombrellën e Komisionit Evropian të drejtuar nga Ursula Von Der Leyen. Kaja Kallas, e cila aktualisht ka edhe postin e nënkryetares së KE, shfaq hapur marrjen e kompetencave të saj dhe kthimin në një vartëse “Përfaqësuesi i lartë/nënkryetari është lidhja midis shteteve anëtare dhe Komisionit – në letër, në teori. Nëse kemi patur probleme se ka dikë mbi mua që në të vërtetë po vendos, atëherë nuk funksionon në atë mënyrë, le të jemi shumë të sqarë.” tha ajo. Në takim informel të fillimit shtatorit në Wicklow në Irlandë mes ministrave të jashtëm dhe

të mbrojtjes, Euractiv raporton se shumica e vendeve të BE e pritën “ftohtë” dhe me “rezerva” planin franko-gjerman për ndryshim strukture të diplomacisë evropiane. Aktualisht, janë 11 nga 27 vende të cilat mbështesin propozimin, me në krye Gjermaninë, Francën por dhe mbështetjen e Italisë të cilat janë lokomotiva e BE. Në krah të Kallas kanë mbetur vetëm disa vende të vogla apo më euroskeptike, të cilat heqjen e vetos e shohin si një humbje totale të fuqisë së tyre për shkak të influencës së madhe dhe drejtimit të Brukselit nga Gjermania dhe Franca. Është e qartë, se për ish kryeministren estoneze, Kaja Kallas, plani i ri sponsorizohet nga Gjermania për të forcuar Von der Leyen në krye të Brukselit. Plani franko-gjerman apo njohur ndryshe si plani Macron Merz, synon përmes ndryshimit të strukturës, edhe ndryshimin e mekanizmit të zgjerimit. Duke hequr veton, për ta zëvendësuar me abstenim. Çfarë do i jepte Brukselit, një vendim marrje më të fortë jo të varur nga kapricot e një vendi që bllokoi me veto, por miratim me shumicë të kualifikuar. Propozimi ditët e fundit nga 11



vende, është parë si një formë presioni nga Gjermania ndaj Brukselit. Berlino heqjen e vetos e ka objektiv më të hershëm, kurse Franca ndonëse mbështetëse, duket më e vakët në këtë fushatë. Por Gjermania si vend lider i BE, paralajmëroi në takimin e Irlandës, se nuk do të dorëzohet lehtë. Ministri i jashtëm i

Gjermanisë, Johan Vadeputh bëri të qartë se synon që për këtë propozim t'i japë fund diskutimeve brenda 6 muajve ndaj dhe ka thirrur një konferencë ministrore më 2 dhjetor në Berlin për të vendosur. Ky debat brenda vetë BE, është më shumë interes për Shqipërinë. Si një vend

pretendent për të hyrë në BE në 2030, Shqipëria do e kishte shumë më të lehtë anëtarësimin nëse bie mekanizmi i vetos. Në të shkuarën, Shqipëria është bllokuar disa herë nga vetot në procesin e nisjes së negociatave edhe pse shumica e vendeve të BE kanë qenë pro zgjerimit dhe anëtarësimit të Shqipërisë.

TRUMP PËR LUFTËN ME IRANIN: SHPËTOVA BRITANINË NGA KËRCËNIMI BËRTHAMOR

Presidenti amerikan Donald Trump ka ashpërsuar retorikën ndaj Britanisë së Madhe, duke pretenduar se ndërhyrja ushtarake amerikano-izraelite kundër Iranit ka mbrojtur edhe Mbretërinë e Bashkuar nga një kërcënim i mundshëm bërthamor. Në një intervistë për GB News, Trump deklaroi se Shtetet e Bashkuara kanë parandaluar një skenar të rrezikshëm, duke argumentuar se siguri i armëve bërthamore nga Irani do të rriste rrezikun për Evropën. “Unë po e shpëtoj edhe vendin tuaj nga kërcënim”, deklaroi Trump, duke theksuar se raketat iraniane kanë kapacitetin për të goditur objektiva në Evropë. Teherani ka mohuar vazhdimisht se synon të ndërtojë armë bërthamore. Trump kritikoi gjithashtu qeverinë britanike për vendimin për të mos u përfshirë drejtpërdrejt në konflikt, duke

përmendur rëndësinë e Ngushticës së Hormuzit për furnizimin me naftë të Britanisë. “Shumë nga nafta juaj vjen nga Ngushtica e Hormuzit dhe ju nuk ishit atje për të më ndihmuar”, tha presidenti amerikan. Ai la të kuptohet se qëndrimi i Londrës mund të ndikojë në mbështetjen amerikane ndaj Britanisë në të ardhmen, duke përmendur edhe çështjen e Ishujve Falkland. Gjatë intervistës, Trump sulmoi sërish kryebashkiakun e Londrës, Sadiq Khan, duke e cilësuar si një “kryetar bashkie shumë të keq” dhe duke kritikuar politikën e tij për emigracionin dhe krimin. Nga ana tjetër, një burim pranë Khan e akuzoi Trumpin se është “i fiksuar” pas kryebashkiakut, duke theksuar se niveli i krimit në Londër ka rënë dhe se qyteti vijon të jetë një metropol global dhe multikulturor.





KOSOVA MERR FLAMURIN E LOJËRAVE MESDHEHETARE, 'PRISHTINA 2030' ZYRTARISHT NË SKENËN MESDHEHETARE

TARANTO, 4 SHTATOR - Kosova ka marrë zyrtarisht flamurin e Lojërave Mesdhetare, duke shënuar kalimin e organizimit nga "Taranto 2026" te "Prishtina 2030". Në ceremoninë madhështore të mbylljes së Lojërave Mesdhetare "Taranto 2026", flamurin e Lojërave Mesdhetare e ka pranuar kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, në një çast historik që shënon nisjen zyrtare të rrugëtimit drejt organizimit të edicionit të vitit 2030 në kryeqytetin e Kosovës. Para më shumë se 20 mijë shikuesve në stadium, flamuri i Kosovës është ngritur përkrah flamurit të Italisë dhe atij të Lojërave Mesdhetare. Flamurin e Kosovës e ka dorëzuar basketbollisti

Adhurim Alijaj, ndërsa ngritja e tij është shoqëruar me intonimin e himnit shtetëror të Kosovës. Në stadium është shfaqur edhe videoja promovuese e "Prishtina 2030", përmes së cilës publikut mesdhetar i është paraqitur nikoqiri i ardhshëm i Lojërave Mesdhetare. Para ceremonisë së dorëzimit, flamurin e Kosovës në ceremoninë mbyllëse të "Taranto 2026" e kanë bartur dy flamurbajtësit e delegacionit të Kosovës, karateisti Islam Selmani dhe Fortesa Orana. Në ceremoninë mbyllëse ishin të pranishëm edhe drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, në krye me presidentin Ismet Krasniqi. Pas marrjes zyrtare të flamurit, kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, e ka cilësuar

këtë çast hap i rëndësishëm drejt organizimit të Lojërave Mesdhetare në Kosovë. "Nga 'Taranto 2026', drejt 'Prishtinës 2030', aty ku ëndrra jonë do të marrë jetë dhe Kosova do ta mirëpresë Mesdheun me krenari! Po vjen koha jonë. Po vjen Prishtina 2030!", ka deklaruar Rama. Me marrjen e flamurit Kosova tashmë ka marrë zyrtarisht stafetën për organizimin e Lojërave Mesdhetare "Prishtina 2030", një ngjarje e madhe sportive që do ta vendosë kryeqytetin dhe Kosovën në qendër të vëmendjes së botës mesdhetare. "Grazie, 'Taranto 2026'! Shihemi në 'Prishtina 2030'!", ka qenë mesazhi i delegacionit të Kosovës pas ceremonisë.



NGA KAMPIONE OLIMPIKE NË TRAJNERE, NORA GJAKOVA NIS NJË KAPITULL TË RI

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Medalistja e artë olimpike e Kosovës në "Tokio 2020", Nora Gjakova, ka lënë pas karrierën si garuese dhe tashmë po ndërton një rrugëtim të ri si trajnere në Federatën e Xhudos së Belgjikës. Debutimi i saj si trajnere ka ardhur në Kampionatin Evropian për Juniorë në Podgoricë, ku ajo ka udhëhequr dy xhudiste të reja, në kategoritë -48 kg dhe -70 kg. Në një intervistë për faqen zyrtare të Federatës Evropiane të Xhudos (EJU), Gjakova ka folur për aventurën e re, sfidat në një vend tjetër dhe misionin e saj të ri si trajnere. Në Belgjikë, Gjakova punon në



pjesën frankofone të vendit, në bashkëpunim me trajnerin brazilian Pedro Guedes. "Është një botë tjetër, por objektivi

mbetet i njëjtë: xhudoja. Të kesh këtë pikë të përbashkët është sikur të kesh një gjuhë të përbashkët. Duke ardhur nga

sporti elitare, e kuptoj presionin, stilin e jetës dhe gjithçka që këta sportistë përjetojnë çdo ditë", është shprehur Gjakova. Për një kampione olimpike, kalimi nga roli i sportistes në atë të trajneres sjell përgjegjësi krejt tjetër. Nuk është më vetëm performanca personale ajo që varet nga vendimet e saj, por edhe zhvillimi i sportistëve të reja. Në këtë proces, Gjakova po mbështetet në përvojën që ka ndërtuar gjatë më shumë se dy dekadave në Kosovë. Pas Gjakovës qëndron një histori e gjatë bashkëpunimi me trajnerin legjendar të Kosovës, Driton "Toni" Kuka. "Mbështetem në atë

që di më së miri. Sistemi që ndërtuam me Tonin solli pesë medalje olimpike. Natyrisht, në Belgjikë duhet të përshtatem me mentalitete të ndryshme, por baza teknike mbetet e njëjtë", ka theksuar ajo. Gjakova ka bërë me dije se vazhdon të jetë në kontakt të vazhdueshëm me Kukën dhe se para se ta pranonte punën në Belgjikë, ka kërkuar këshillën e tij. "Jam në kontakt të vazhdueshëm me Tonin. Para se ta pranoja këtë punë, kërkoja këshillën e tij dhe mora bekimin e plotë. Mbështetja e tij në këtë kapitull të ri do të thotë shumë për mua", ka thënë Gjakova.

FIFA AKUZON UEFA-n PËR 'FUSHATË SHPIFËSE' KUNDËR INFANTINOS

ZURICH, 4 SHTATOR - Përplasja në mes të FIFA-s dhe UEFA-s ka marrë një tjetër kthesë, pasi institucioni botëror i futbollit e ka akuzuar UEFA-n për një "fushatë shpifëse" kundër presidentit Gianni Infantino dhe drejtuesve të FIFA-s. Në qendër të konfliktit është projekti i braktisur FIFA Forward Enterprise (FFE), përmes të cilit FIFA kishte planifikuar të shiste 20 për qind të një kompanie të re komerciale te investitorët privatë. UEFA kishte kërkuar nga një gjykatë në ShBA qasje në dokumentet e FIFA-s si pjesë e përgatitjeve për pretendime të mundshme ligjore në Zvicër. Organizata evropiane e ka akuzuar Infantinon për "keqmenaxhim kriminal" dhe ka

pretenduar se projekti ishte bazuar në një vlerësim jo të drejtë të aseteve të FIFA-s. FIFA ka kundërshtuar këto akuza, duke argumentuar se FFE ishte vetëm një propozim dhe se zbatimi i tij do ta kërkonte miratimin e organeve përkatëse dhe mbështetjen e federatave anëtare. Në dokumentet e saj ligjore, FIFA e ka akuzuar UEFA-n se, në vend që të merrte pjesë në procesin institucional, ka nisur një "fushatë shpifëse" kundër saj dhe Infantinos. FIFA pretendon gjithashtu se UEFA ka motiv ekonomik për ta kundërshtuar projektin, pasi forcimi financiar i federatave më të vogla do ta rriste konkurrencën në futbollin botëror dhe do ta



zvogëlonte ndikimin e futbollit evropian. UEFA, ndërkohë, po kërkon dokumente edhe nga investitori amerikan, Joshua Kushner dhe kompania e tij "Thrive Eternal", e

cila ishte planifikuar të ishte investitori kryesor në projekt. Marrëveshja parashikonte një investim prej 4.2 miliardë dollarësh për 20 për qind të kompanisë së re komerciale të

FIFA-s, por projekti u braktis vetëm disa ditë pasi u bë publik në korrik. Kushner më vonë ka shprehur keqardhje për përfshirjen në projekt, duke pranuar se nuk e kishte kuptuar se sa e ndërlikuar do të ishte dinamika politike e futbollit botëror. UEFA pretendon gjithashtu se asetet e lidhura me Kupën e Botës ishin vlerësuar në rreth 15 miliardë funte, pa një proces të hapur dhe konkurrues apo një vlerësim të pavarur. Përplasja mes dy institucioneve tashmë është shndërruar në një betejë të hapur ligjore dhe mund të ketë pasojë të rëndësishme për drejtimin e futbollit botëror dhe të ardhmen e presidencës së Infantinos.

DEBAT PUBLIK

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook


www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Milazim Dana shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Shaban Kryeziu shpall të pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Driton Bucaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Abdyl Frasheri “ Prizren.
- Armend Hoxhaj shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K “11 Marsi “ Prizren.
- Trim Rezniciq shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.
- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.
- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Sebastjan Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.f.m.u “Ahmet Rustemi” Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Xhelal Haliloshmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Diana Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Albana Gjocaj nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e universiteti Publik “Fehmi Agani” Gjakovë, drejtimi Infermieri, Bachelor me nr. 104.
- Atdhe Gashi shpall të pavlefshme dëftesat diplomën si dhe certifikatën e diplomës të shkollës së mesme Teknike “28 Nëntori” Prishtinë.
- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.
- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.
- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.
- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

